

RREGULLORE

E FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOORDINUES
TË ARSIMTARËVE NË DIASPORË



KËSHILLI KOORDINUES
— I ARSIMTARËVE NË DIASPORË —

NENI 1

OBJEKTI

1. Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë (KKAD).
2. Rregullorja e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë hartohet në bazë dhe në zbatim të pikës 13/1 të vendimit nr. 469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, të ndryshuar.
3. Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në Diasporë funksionon pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën si organ këshillimor për çështjet e mësimin të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë.

NENI 2

QËLLIMI

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat lidhur me kushtet dhe mënyrën për:

- a) zgjedhjen, organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë;
- b) të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë në lidhje me përmbushjen e detyrave të caktuara sipas kësaj rregulloreje;
- c) mënyrën e organizimit të mbledhjeve të Këshillit, administrimin e dokumenteve të krijuara për vendimmarrje dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit.

NENI 3

FUNKSIONIMI

1. Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në Diasporë përbëhet nga 10 anëtarë të përzgjedhur nga radhët e mësuesve me origjinë shqiptare që punojnë në diasporë, organizatorë të zhvillimit të mësimin të gjuhës shqipe në diasporë.
2. Mbledhja e Këshillit konsiderohet e vlefshme kur në të marrin pjesë dy të tretat e anëtarëve. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë. Në mbledhjen zyrtare të Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë merr pjesë drejtori i Qendrës së Botimeve për Diasporën, si dhe të ftuar të tjerë kur vlerësohet e nevojshme.

Këshilli Koordinues i Arsimit në Diasporë ka këto kompetenca:

- a) jep informacione dhe mendime lidhur me çështjet e arsimit në gjuhën shqipe në diasporë si dhe bën propozime konkrete të lidhura me to;
- b) organizon në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Qendrën e Botimeve për Diasporën (QBD) takime me arsimtarët në diasporë;
- c) jep mendime për botime të teksteve nga QBD-ja për mbështetjen e mësimin të gjuhës dhe kulturës shqiptare në diasporë;
- ç) jep mendime për përmirësimin e zhvillimit profesional të mësuesve në diasporë dhe të mënyrës së bashkëpunimit me ta.

1. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Koordinues të Arsimit në Diasporë emërohen dhe shkarkohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, me propozim të MEPJ-së.
2. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Arsimit në Diasporë duhet të jenë mësues në diasporë dhe të kenë të paktën 5 (pesë) vite eksperiencë pune në fushën e mësuesisë.

Struktura organizative e Këshillit Koordinues të Arsimit në Diasporë miratohet me këtë Rregullore, si më poshtë:

1. Struktura organizative e Këshillit Koordinues të Arsimit në Diasporë përbëhet nga kryetari, 2 (dy) nënkryetarë dhe sekretari.
2. Kryetari emërohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, ndërsa 2 (dy) nënkryetarët dhe sekretari, zgjidhen nga anëtarët e këtij Këshilli.
3. Zgjedhja e strukturës organizative bëhet me short, sipas një sistemi pikësh. Çdo anëtar voton për tre anëtarë të tjerë, duke i dhënë secilit prej tyre tre, dy dhe një pikë. Anëtarin që mbledh më shumë pikë është nënkryetari i parë, nënkryetari i dytë dhe i treti sekretari. Kryetari nuk ka të drejtën e propozimit e as të votimit.
4. Zgjedhja e 2 (dy) nënkryetarëve dhe sekretarit bëhet me votim të fshehtë.

1. Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në Diasporë mbledhet jo më pak se 1 (një) herë në muaj.
2. Mbledhja e Këshillit thirret me nismën e kryetarit të Këshillit apo me kërkesën e jo më pak se një të tretës së anëtarëve të tij.
3. Kryetari është i detyruar të thërrasë një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën dy anëtarë të Këshillit ose me kërkesë të drejtorit të QBD-së. Kërkesa duhet të përmbajë qëllimin dhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje së bashku me materialet përkatëse.
4. Sekretari i Këshillit duhet të njoftojë anëtarët e Këshillit për mbledhjen, me postë elektronike ose me shkrim, 5 (pesë) ditë pune para datës së caktuar për mbledhjen e Këshillit. Data e njoftimit të anëtarit të Këshillit do të konsiderohet data e dërgimit të njoftimit.
5. Njoftimi për mbledhjen duhet të përmbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, si dhe materialet që do të shqyrtohen.
6. Mbledhja e Këshillit, si rregull, zhvillohet online ose në një vend tjetër të paracaktuar në mbledhjen pararendëse nga kryetari i Këshillit dhe të miratuar nga shumica e anëtarëve.

1. Mbledhja e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë drejtohet nga kryetari dhe në mungesë të tij nga njëri prej nënkryetarëve.
2. Mbledhja e Këshillit është e vlefshme nëse marrin pjesë shumica e thjeshtë e anëtarëve të Këshillit. Në rastet kur nuk plotësohet ky numër, drejtuesi i mbledhjes e shtyn atë për një ditë tjetër, duke njoftuar për këtë qëllim edhe anëtarët që nuk ishin të pranishëm në mbledhje.
3. Në mbledhjen e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë merr pjesë anëtari i Këshillit i ngarkuar për çështjet e arsimit.
4. Në fund të mbledhjes, kryetari deklaron mbylljen e saj. Nëse çështjet e rendit të ditës nuk shqyrtohen brenda ditës së mbledhjes, kryetari mund të vendosë shqyrtimin e tyre në mbledhjen tjetër të Këshillit ose ta shtyjë mbledhjen për një ditë tjetër.
5. Procesverbali në mbledhjen e Këshillit mbahet nga sekretari i Këshillit.
6. Vendimet e Këshillit publikohen. Vlerësimet, debatet që bëhen gjatë shqyrtimit të materialeve të paraqitura dhe marrjes së vendimeve në Këshillin Koordinues janë konfidenciale.

1. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare në kryesi, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
2. Anëtari i Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë lirohet para mbarimit të mandatit 4-vjeçar, në rastet kur:
 - a) jep dorëheqjen me kërkesë individuale,
 - b) e ushtron veprimtarinë në kushtet e konfliktit të interesit.
3. Anëtari i Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë shkarkohet para mbarimit të mandatit 4-vjeçar, në rastet kur:
 - a) nuk përmbush funksionet e parashikuara nga Ligji nr. 16/2018, “Për Diasporën”, i ndryshuar, si dhe në këtë rregullore.
 - b) nuk merr pjesë në mbledhjen e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë për më shumë se 2 (dy) herë radhazi (pa dhënë arsye);
 - c) bëhet i paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara për shkak të sëmundjeve fizike ose mendore për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj.

1. Kryetari, nënkryetarët dhe sekretari i Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë zgjidhen nga radhët e anëtarëve të tij.
2. Kryetari i Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë përfaqëson Këshillin Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë në marrëdhënie me të tretët dhe jep deklarata në emër të tij. Ai është zëdhënës i vendimmarrjes kolektive të Këshillit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
3. Kryetari i Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë ka këto detyra, por pa u kufizuar në to:
 - a) drejton mbledhjen e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë, duke vlerësuar zbatimin e parimeve dhe etikës, si dhe garanton të drejtën e shprehjes së opinionit për të gjithë anëtarët e Këshillit;
 - b) bashkërendon organizimin e mbledhjeve të Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë në bashkëpunim me sekretarin e këtij Këshilli dhe koordinon objektivat dhe detyrat e anëtarëve të tij;
 - c) së bashku me dy nënkryetarët, informon anëtarët e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë kur vepron si i tillë në marrëdhënie me palë të treta me të drejtat e përfaqësimit për çështje të ndryshme.

1. Dokumentimi i mbledhjeve të Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë mbahet nga sekretari i Këshillit me anë të procesverbaleve. Në procesverbal duhet të tregohet pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit dhe e të ftuarve të tjerë në mbledhje, diskutimet, propozimet, vërejtjet që bëhen në mbledhje, si dhe rezultatet e votimit për vendimet që merren.
2. Sekretari i Këshillit mban shënime në procesverbal për anëtarët e Këshillit që morën pjesë në mbledhje, pjesëmarrësit, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, formën dhe rezultatit e votimit, datën dhe vendin e mbledhjes.
3. Procesverbali i mbledhjeve të Këshillit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm dhe nga sekretari i Këshillit ose u dërgohet një kopje konfirmuese e tij. Procesverbali miratohet nga anëtarët e Këshillit në mbledhjen pasardhëse.

1. Çdo anëtar i Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë, përmes deklarimit me shkrim, duhet të kërkojë heqjen dorë nga pjesëmarrja në mbledhjen e Këshillit kur ndërmjet tij dhe personave ose subjekteve juridike për të cilat diskutohet, shqyrtohet, vlerësohet dhe kryhet çfarëdolloj procedure për çështje konkrete ka konflikt interesi.
2. Anëtari i Këshillit nuk merr pjesë në procedurat e shqyrtimit, diskutimit dhe votimit nëse ka interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për çështjen, interes i cili cenon paanësinë e tyre në vendimet që do të merren.

1. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë ndajnë midis tyre detyrat për ndjekjen e çështjeve dhe miratojnë ecurinë e tyre. Përcjellja e çështjeve të ndryshme dhe propozimet për zgjidhjen e tyre pranë institucioneve shtetërore realizohen nëpërmjet bashkëpunimit me strukturat administrative pranë MEPJ-së, MAS-it dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën.
2. Secili nga anëtarët e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë organizon sipas nevojës, takime me shoqata të shqiptarëve në diasporë dhe me komunitetin në funksion të interesit të mësimdhënies atje. Takimi mund të zhvillohet edhe në mjediset e përfaqësive

diplomatike dhe/ose konsullore shqiptare në shtetin pritës apo në mjedise të tjera të përshtatshme. Anëtarët duhet të informojnë Këshillin Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë mbi takimet e zhvilluara dhe rezultatet e tyre.

NENI 14

MIRATIMI DHE NDRYSHIMI I RREGULLORES

1. Rregullorja e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë miratohet nga jo më pak se dy të tretat e anëtarëve të KKAD-së.
2. Procedura për ndryshimin e kësaj Rregulloreje fillon me kërkesën e një të tretës së anëtarëve ose me kërkesën e kryetarit të tij.

NENI 15

HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore miratohet nga anëtarët e KKAD-së, më datë 02.10.2024:

1. Mira Shehu
2. Teuta Tabaku
3. Anila Kadija
4. Miradije Berisha
5. Isuf Bytyçi
6. Aurela Konduri
7. Dritan Mashi
8. Arta Emiri
9. Anita Duriçi
10. Mustafë Krasniqi